



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM
Nr. 472, datë 13.10.2021

PËR
CAKTIMIN ME SHORT TË RELATORIT TË PROCEDIMIT DISIPLINOR NR.8/2021,
TË FILLUAR NDAJ MAGJISTRATIT, {...}, ME DETYRË GJYQATAR NË GJYKATËN
E RRETHIT GJYQËSOR MA{...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 63 të ligjit nr.115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, në nenet 138 dhe vijues të ligjit nr.96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në nenin 16 të Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur, mbi propozimin e Kryetarit të Komisionit Disiplinor, z.Medi Bici, pas hedhjes së shortit,

VENDOSI:

1. Caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor, z. Medi Bici, në cilësinë e relatorit të procedimit disiplinor nr.8/2021, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj magjistratit, {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}.
2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit, {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR